



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Nr. 498/22
Data/Datum: 19.10.22

PRISHTINË - PRISHTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 498/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani- Kryetare, Vedat Poterqoi- Referuese si dhe Kimete Gashi- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) "Botek shpk" Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me tabel të mençura për Insitucionet arsimore" me numër të aktivitetit 616-22-8816-1-1-1, iniciuar nga Komuna e Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me 19.10.2022, mori:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE "Botek shpk" në Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 03.10.2022, numër protokollit 498/2022, kurse Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, i lejohej ta vazhdoj aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me tabel të mençura për Insitucionet arsimore" me numër të aktivitetit 616-22-8816-1-1-1;
2. Konfiskohet shuma e mjeteve të deponuara për tarifën ankimore të OE "Botek shpk" Prishtinë, konform nenit 31 par 5 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.08.2022, Komuna e Prishtinës, nga cilësia e saj si Autoritet Kontraktues ka publikuar Njoftimin për iniciimin e aktivitetit të prokurimit "Furnizimi me tabel të mençura për Insitucionet arsimore" me numër të aktivitetit 616-22-8816-1-1-1;

Me 28.09.2022, OE "Botek shpk" Prishtinë, ka ushtruar Kerkese për rishqyrtim sipas së cilës ka kërkuar mesd tjerash që nga Specifikimet teknike të detyrueshme, të largohet kerkesa e AK, që Tabelat e mençura (Smart Board) të posedojnë patjetër portet e ashtuquajtura "Coax

IN dhe Coax Out" meqë sipas Ankuesit kjo konsiderohet e panevojshme teknikisht dhe profesionalisht dhe diskriminuese sepse favorizon vetem nje prodhues te dyshimte.

Me Vendimin e datës 29.09.2022, Autoriteti Kontraktues e ka aprovuar pjesërisht kërkesën e OE "Botek shpk" me ç'rast:

- Ka aprovuar kërkesën e cila ka te beje me ISO Certifikaten 14001;
- Nuk ka vendosur që nga Specifikimet e detyrueshme teknike, të evitohet kërkesa që portet "Coax IN dhe Coax Out" të jenë pjesë përbërëse e "Tabelave të Mençura".

Sikurse mund të kuptohet dhe nga përmbajtja e ankesës, Ankuesi i është drejtuar sërish AK, me të njëjtën kërkesë, por nuk ka pranuar ndonjë pergjigje. Prandaj OE "Botek shpk" me 03.10.2022, ka parashtruar Ankese në Oragnin Shqyrtues të Prokurimit (Nr: 498/22), kunder Njoftimit per kontrate te aktivitetit te prokurimit, përshkruar si më sipër. Sipas pohimeve nga Ankesa, nënkuptohet se i njëjti konsideron se qasja e AK ka të bejë me tendencën per te favorizuar nje prodhues dhe nje OE te caktuar. Për këtë arsye, ka atakuar Vendimin mbi publikimin e ketij aktivitetit të prokurimit, duke kërkuar nga OSHP:

- Të anulohet Vendim i AK, per Refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim;
- Te obligohet AK, që ti largojë nga kjo pjesa e Dosjes së Tenderit (Specifikimet teknike të detyrueshme) kërkesat për portet" Coax IN dhe Coax Out" si pjesë përbërëse e Ekrameve të Mençura.

Duke ju referuar të lartëcekurave Ankuesi pretendon se aktet e nxjerrura dhe veprimet e AK, konsistojnë në shkeljet e dispozitave te Ligjit nr. 04/L - 042 per Prokurimin Publik te Republikes se Kosoves, duke i cituar ne ketë rast: Nenin 1 (Qellimi); Nenin 7 (Barazia, Trajtim/ Jo – Diskriminimi); Nenin 28 (Specifikimet teknike), përfshirë shkeljet e nenit 20 (Specifikimi teknik) dhe Neni 8 (Vendimi i Autoritetit Kontraktues), sipas Rregullave dhe Udhezuesit Operativ per Prokurimin Publik.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 dhe 114 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. I njëjti, e ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 10.10.2022, sipas të cilit i propozon panelit që:

1. Ankesa te aprovohet si e bazuar;
2. Te ndryshohen specifikacionet teknike, te cilat konsiderohen diskriminuese;

Sipas ekspertit shqyrtues, kërkesa per perdorimin e nje teknologjie te tille, kufizon OE per te ofertuar me produkte te avancuara; kërkesa qe pajisja te posedoje portet e siperpermendura pamundeson qe te ofertohet me pajisje me te reja” dhe “kufizon qe te ofertohet vetem me nje produkt te caktuar; vendosja e ketij kriteri, paraqet kriter diskriminues; ndikon te blihen pajisje me teknologji te vjetruar dhe perjashton teknologjine me te re. Duke shpjeguar po ashtu se, cituar: “Portet "Coax IN dhe Coax

Out" sherbejne per transmetimin e sinjalit, permes kabllit koaksial, e cila eshte teknologji e vjeter dhe pothuajse te gjitha pajisjet e reja, nuk e perdorin me kete teknologjike”.

Duke ju referuar shkresave të kësaj lënde dhe provave në dispozicion të cilat janë ofruar nga palët dhe eksperti shqyrtues i prokurimit, Paneli konsideroi se nuk ka nevojë të mbahet seanca publike me palë, meqë faktet dhe provat në dispozicion ofrojnë informacione të mjaftueshme për ta vlerësuar në mënyrë meritore çështjen në rastin konkret. Nga ky aspekt, Paneli konstaton se, Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizime. Vlera e parashikuar e kontratës: 400.000, 00 €. Për zbatimin e këtij aktiviteti, AK ka publikuar Njoftimin për kontratë, së bashku me specifikimet teknike të detyrueshme, tani më të njohura për palët dhe Panelin. Duke i analizuar në këtë rast, veprimet e përshkruara si më sipër nga të dyja palët (AK dhe OE) Paneli mori në konsideratë të gjitha deklaratimet e tyre, përfshirë pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e AK, dhe mendimin e ekspertit shqyrtues.

Duke i analizuar dhe krahasuar të gjitha këto me parimet dhe dispozitat përkatëse të LPP, Paneli konstatoi mes tjerash se, nga përmbajtja e ekspertizës kuptohet fare qartë se eksperti ka kërkuar shpjegime plotësuese lidhur me arsyet e aplikimit të kërkesave të tilla (shpjeguara si më sipër) nga kuadri i specifikave teknik të detyrueshme, për të cilat AK me 10.10.2022 është pergjigjur dhe ka shpjeguar se:

- Specifikimet teknike janë te përgatitura nga eksperte e IT - Drejtoria per Arsim;
- AK i ka informuar OE, nga cilësia e tyre si palë të interesuara se, nese dorezojne specifika me te avancuara ato do te jene te pranueshme;
- AK ka shpjeguar se pranohen specifikat me te avancuara, natyrisht duke e deshmuar këtë përmes dokumentacionit provues;

Gjatë analizimit të shkresave të kësaj lënde dhe krahasimit të tyre, Paneli Shqyrtues vërejtë se: Shpjegimet e cituara si më sipër të AK, nuk janë mohuar nga Ankuesi dhe as nga Eksperti; Ankuesi ka kërkuar domosdo vetëm largimin e kriterëve (tani më të shpjeguar) nga specifikimet teknike të detyrueshme; Specifikimet teknike janë kompatible me qëllimin e prokurimit dhe nevojat primare të AK; Nisur nga ky kontekst, Paneli Shqyrtues konsideron se secili AK gëzon pavarësinë institucionale për harimin e kushteve të një aktivitetit të prokurimit të cilat në këtë rast nga pikëpamja e këtij Paneli ato janë hartuar në harmoni me nenin 27 (Dosja e Tenderit) të LPP, sipas të cilit, autoriteti kontraktues do të përpilojë një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termat dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Fakti se, AK ka deklaruar se pranohen specifikat me te avancuara, do të thotë se ka vepruar në harmoni me parimet e tregut liberal dhe të konkurrencës, ashtu sikurse parashihet kjo në kontesktin integral të nenit 28 (specifikimet teknike) të LPP. Dhe, nëse eventualisht Interesi ekonomik i ankuesit nuk përputhet me specifikat

teknike të detyrueshme, kjo nuk do të thotë se AK ka hartuar specifikime teknike në kundërshtim me nenin 28, sipas të cilit, autoritetit kontraktues i ndalohet të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Paneli konsideron se, qasja e AK i cili i ka informuar të gjithë OE, nga cilësia e tyre si palë eventuaisisht të interesuara se nese dorezojne specifika me te avancuara ato do te jene te pranueshme dhe po ashtu se do të pranohen specifikat me te avancuara (natyrisht duke i deshmuar ato përmes dokumentacionit provues), krijon objektivisht bindjen e këtij Institucioni se, AK I ka trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP. Dhe nisur nga këto konstatime Paneli konsideron se AK duhet ti lejohet rrjedha normale e këtij aktiviteti të prokurimit sikurse kërkohet me nenin 104, të LPP (Parimet themelore) sipas të cilit, procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës në fjalë. Nga ana tjetër, asnjë vendim i OSHP nuk do të merret në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër, sikurse kërkohet kjo me paragrafin 2, të nenit 104, të Ligjit të cituar.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartëcekurat, Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj Mexhuani

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK-sw

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.